



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 10.02.2020, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Valbona Petrovci (e pavarur), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (e pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur) dhe Sokol Berisha (i pavarur).

Munguan: Adrian Berisha (PSD), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK) dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Shkumbin Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kulet, kryesues i Kuvendit, i cili kërkoi nga të pranishmit që të mbahet një minutë heshtje me rastin e përvjetorit të vrasjes së Mon Balajt dhe Arben Xheladinit, si dhe vdekjes së znj. Nexhmije Pagarusha.

Kryetari i Komunës, Shpend Ahmeti, propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika e 12 "Propozimvendimi për autorizim të borxhit", për shkak të diskutimit me Ministrinë e Financave.

Vlora Dumoshi bëri të ditur se sivjet është 100-vjetori i lindjes së profesor Anton Çettës dhe 30-vjetori i Lëvizjes së madhe të pajtimit të gjaqeve. Kjo Lëvizje që i bashkoi vajza e djem, të rinjë e të vjetër, që u bë shtytje themelore për programin e mëvonshëm për liri, pavarësi dhe demokraci për popullin shqiptar të Kosovës.

Duke pasur parasysh këto, kërkojmë që të futet në rend të ditës propozimi "Caktimi i lokacionit për vendosjen e bustit të prof. Anton Çetës.

Shpend Ahmeti, kryetar, tha se për mbledhjen e radhës ky propozim do të jetë i gatshëm, andaj kemi propozuar që ky bust të vendoset aty afër bustit të prof. Fehmi Aganit.

Eman Rahmani theksoi se është kërkesë e shumicës së bizneseve, por edhe qytetarëve, që dita e diel të jetë ditë pushimi pothuajse për të gjitha bizneset në komunën e Prishtinës, dhe propozoj që në rend të ditës për shqyrtim të futet edhe pika "Propozimrregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, të organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës".

Shpend Ahmeti, kryetar, tha se këtë propozimrregullore do ta dërgojmë për shqyrtim në Komitetin për zhvillim ekonomik, ku dhe do të dalë në diskutim publik.

Sami Boroci theksoi se propozimrregullorja duhet t'i nënshtrohet një debati ndoshta pak më të madh. Sa i përket ditës së diell si ditë pushimi, të jetë një diskutim publik më i gjerë, në mënyrë që kur të vije në Kuvend, t'i ketë të përfshira shqetësimet dhe kërkesat e aktorëve që preken nga kjo rregullore.

Kryesuesi tha se këtë propozim do ta marr si obligim, që në Komitetin për Politikë e Financa me e iniciuar fillimin e procedurës për dëgjim publik.

Agim Gashi propozoi që për seancën e radhës së Kuvendit, në rend të ditës të futet propozimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të prof. Anton Çettës, dhe që drejtoritë përkatëse ta kryejnë punën e tyre në kontakt me grupet e interesit.

Me propozimin, që nga rendi i ditës të hiqet pika e dymbëdhjetë, kryesuesi konstatoi se më 36 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2019 (TM4);
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2019;
4. Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Naxhije (Rashit) Herticës, Bahrije Pakashticës dhe Mustafa Pakashticës;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Zuka (Isuf) Bekës;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arton Topanicës, Ismit (Avdi) Shabanit, Sabit (Avdi) Shabanit, Adem (Shaban) Berishës dhe Sylejmon (Sadik) Topanicës;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut;
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik Breznicës dhe Osman Breznicës;
11. Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës;
12. Propozimvendimi për autorizim të borxhit;
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 1 abstenim, u miratua i ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2019 (TM4).

Lidhur me Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2019 (TM 4), në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave.

Halim Halimi tha se është shqetësuese për Grupin parlamentar të LDK-së, sepse sipas raportit të shpenzimeve kapitale, ku nga një buxhet me mbi 46 milionë euro të parapara për kategori të ndryshme, Komuna ka shpenzuar vetëm 18 milionë e 845.000 euro, apo vetëm 40.94%, të mjeteve të cilat i ka pasur në dispozicion. Nëse i krahasojmë këto shpenzime me vitet paraprake, vërejmë se niveli i ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale, dëshmon për një paaftësi të Komunës së Prishtinës për të planifikuar dhe realizuar projektet kapitale. Nëse shikohen të hyrat me buxhetin e vitit 2019, janë planifikuar në shumë prej 31 milionë e 733,984.00 euro, ndërkaq janë realizuar 31,433.141 96, apo 99.05%. Kjo në shikim të parë duket se është një rritje, është realizuar buxheti d.m.th. 99%, mirëpo nëse shikojmë në detale, del se kemi një ngecje edhe në arkëtimin e të hyrave vetanake nga disa kategori. Nëse shikojmë sipas drejtorive, kemi disa drejtori të cilat shumë pak e kanë realizuar buxhetin e planifikuar.

Nga e gjithë kjo shihet se është bërë një keqplanifikim dhe kemi një diskrepancë në mes të planifikimit dhe realizimit të buxhetit, kështu që e gjitha kjo është si një rezultat i një keq menaxhimi dhe keq planifikimi.

Mirsad Vitia fillimisht ngriti një shqetësim rreth të hyrave vetanake për vitin 2019, duke kërkuar të dijë arsyen e rënies së të hyrave në kategoritë, si qiraja në banesa, shpronësimet, taksa për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, parkingjet, licencat në biznes, për të vazhduar tutje me të hyrat përmes thesarit, si gjobat e Gjykatës, Agjencia e Pyjeve, donacionet etj. Një fenomen interesant që po e përcjell ekzekutivin komunal nga viti në vit, është se gjatë tre muajve të vitit drejtoritë përkatëse nuk e shfrytëzojnë buxhetin më shumë sesa në muajin dhjetor, kjo për arsye krejt të thjeshtë, në mënyrë që në fund të vitit atyre t'iu teprojnë sa më pak para.

Sikur të kishte qenë planifikimi dhe menaxhimi i mjeteve më i mirë, gjëra të tilla nuk do të përsëriteshin çdo vit. Këtë më së miri e vërejmë tek shpenzimet kapitale, por ky ekzekutiv nuk ia del të shpenzojë as gjysmën e buxhetit të ndarë për projekte kapitale.

Kur jemi tek shpenzimet në projekte kapitale, për periudhën janar-dhjetor 2019, të drejtorive përkatëse, vërejmë se vetëm dy drejtori arrijnë të kalojnë përqindjen mbi 70%, Drejtoria e Parqeve edhe Drejtoria e Shëndetësisë, kurse në anën tjetër kemi edhe drejtori, siç është ajo e Bujqësisë, të ë cilat përkundër faktit që kanë buxhet qindra mijëra euro, nuk arrijnë të shpenzojnë asnjë cent.

Leutrim Retkoceri tha se buxheti i vitit 2019 nuk ka ndryshuar asgjë në përmbajtje, përveç se disa shifrave që na vijnë të përsëritura, me pak ndryshime, dhe se ky buxhet nuk është që merret dhe e menaxhon zhvillimin që i duhet Komunës së Prishtinës. Buxhet i koncentruar kryesisht në shpenzime në paga, mallra dhe mëditje, mirëpo më pak në investime kapitale, ku më së shumti ka nevojë Komuna e Prishtinës.

Po ashtu, janë shqetësuese edhe përmbarimet, apo proceset gjyqësore, ku paditet Komuna e Prishtinës.

Mendoj se ky buxhet nuk donë shumë analizë, për me e shikuar se Komuna e Prishtinës nuk është duke e përmbush aspektin elementarë të saj, menaxhimin e zhvillimit të Komunës së Prishtinës, e që me këtë buxhet del që në investime kapitale ka shumë ngecje.

Valbona Ajeti tha se neve na është prezantuar Raporti financiar vjetor për vitin 2019, i cili është përgatitur në bazë të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Sa i përket realizimit të buxhetit në investimet kapitale, mendoj se përqindja prej 75% e realizimit të buxhetit nuk qëndron, dhe si shembull konkret mund të merren projektet në rregullimin e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në Hajvali, projekte të cilat ende nuk janë realizuar.

Në shumë lagje të qytetit mungon ndriçimi, konkretisht në lagjen "Bajram Bahtiri". Gjithashtu janë të ndara disa mjete financiare për disa fusha sportive dhe asnjë nga ato projekte nuk janë realizuar. Po ashtu, edhe në disa shkolla mungojnë edhe pjesët kryesore të inventarit etj.

Arbenita Murseli tha se sa i përket këtij raporti financiar të tremujorit të fundit të vitit 2019, disa projekte të Drejtorisë së Shërbimeve Publike edhe përkundër ndarjes dhe sigurimit të mjeteve financiare në shumën prej 280.000 euro, projekti për trajtimin e qenve endacakë ka mbetur pa u realizuar.

Po ashtu edhe projekti për vendosjen e kamerave të sigurisë në kryeqytet, ku janë të siguruara gjithsejtë 100.000 euro, asnjë euro nuk është shpenzuar për realizimin e tij.

Ai kërkoi nga kjo drejtori që të merren iniciativa dhe të realizohen këto projekte.

Fiknete Bejta tha se gjatë analizës së këtij raporti kemi vërejtur nga Komuna një efikasitet më të madh tek mbledhja e të hyrave vetanake nga të gjitha dikasteret, duke ndikuar kështu në trendin pozitiv. Kemi vërejtur gjithashtu se në këtë tremujor Komuna ka shpenzuar më shumë tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të subvencionet dhe transferet, si dhe kategoria buxhetore për investime kapitale.

Vlen të potencojmë se ka më pak mbledhje të të hyrave tatimore dhe jo tatimore, sipas planifikimit, por kemi më pak pra për 7.18%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Sipas materialit të prezantuar nga Drejtoria e Financave, përmes këtij raporti shihet një performacë e dobët tek disa zëra buxhetor, p.sh. tek shpronësimet, ku realizimi i shpenzimeve është 0%, apo tek të hyrat nga donacionet kemi shpenzime 0%. Sidoqoftë, në përgjithësi ky tremujor, në krahasim me vitin 2018, niveli i arkëtimit të të hyrave vetanake është më i ulët për 10.31%.

Për mos realizimin e projekteve një ndikim të madhe ka edhe prokurim publik, i cili do ta përcjellin çdo qeverisje edhe në të ardhmen. Andaj ne si asamblistë duhet të bëjmë presion me të gjitha mjetet që i kemi për ta ndryshuar këtë ligj. Edhe nëse ndodh ky ligj, ndikimi më i madh duhet të bëhet tek shkurtimi i afateve për ankesat nga operatorët ekonomikë.

Shefqet Osmani, fillimisht u përqendrua rreth shpenzimeve, konkretisht te shpenzimet e ujit në vitin 2018, duke thënë se Komuna i ka pasur 185.000 euro, ndërsa në vitin 2019, 400.000 euro. Lidhur me këtë kërkoi të dijë arsyen e rritjes së mjeteve për vitin 2019.

Po ashtu, e njëjta çështje na paraqitet edhe te ngrohja, te mbledhja e mbeturinave, andaj është dashtë që këto ndryshime të specifikohen.

Pastaj shqetësuese janë edhe disa detyrime kontingjente dhe shpenzime të paspecifikuara edhe në Drejtorinë e Kulturës. Gjithashtu vlen të theksohet se dukuri shqetësuese janë edhe punësimi i 210 persona me kontratë mbi vepër, apo shërbime të veçanta.

Agim Gashi theksoi se sipas të dhënave që na paraqiten në këtë raport, shihet se 16 milionë e 81,346 euro kanë qenë bartje për investime kapitale, tjerat kanë qenë të fushave të tjera, prej të cilave vetëm 6 milionë e 397,864 janë shpenzuar këtë vit. Sipas këtyre të dhënave

vërehet se ka mjete financiare që nga viti 2017, '18, '19 , mjete të cilat nuk janë shpenzuar dhe po barten nga vitit në vit. Raporti financiar vjetor duhet me qenë pjesë e raportit të punës së qeverisë komunale dhe Kryetarit të Komunës. Ne asnjëherë nuk do të jemi të fuqishëm t'i trajtojmë problemet që i ka Komuna e Prishtinës, në qoftë se para nesh nuk vihet raporti vjetor i punës, pjesë e së cilës duhet me qenë edhe raporti financiar buxhetor. Mendoj se Komuna e Prishtinës nuk do të ketë performancë pozitive sa i përket qeverisjes për 2019, sepse një nga kriteret është shpenzimi i mjeteve financiare për projektet kapitale minimumi 70%. Për mos realizimin e këtij kriteri, Komuna nuk do të mund të përfitojë benificione as nga Qeveria e Kosovës, as nga përkrahës të tjerë financiar.

Kur bëhet planifikimi i buxhetit, duhet të shihen projekte të realizueshme brenda vitit buxhetor, jo të futen pa analizë paraprake, sepse ato i merr niveli qendror. Pra, problemi është tek politikëbërja, te planifikimi i mirë, dhe këtë po kërkojmë. Nuk po flasim vetëm për të gjykuar dikë, por po flasim për të dhënë kontributin.

Neve na merren 4 milionë e 177.000 euro nga Qeveria, sepse nuk kemi qenë të zotë me i shpenzuar, kur dihet se nevojat janë shumë të mëdha në të gjitha fushat. Qeveria komunale duhet të shfrytëzojë kapacitetet e Kuvendit dhe burimet tjera të bashkëpunimit, për me mundur me bërë një plan të punës sa më të realizueshëm dhe me ngritur shkallën e realizimit të buxhetit si në të hyra, si në shpenzime, dhe me i përmbush nevojat sipas planifikimit.

Jeta Rafuna-Hasani tha se një qeverisje komunale me kaq shumë drejtori dhe me kaq pak realizime të projekteve, tregon qartë paaftësinë dhe mosvullnetin e tyre për punë.

Shpenzimet nga investimet kapitale kanë qenë vetëm 32%, e jo 40%, siç paraqiten në raport. Te Drejtoria e Infrastrukturës, shpenzimet e mjeteve për realizimin e projekteve kanë qenë 42.27%, te Drejtoria e Shërbimeve Publike, vetëm 24.85% e realizimit të buxhetit, te Drejtoria e Kulturës vetëm 45% të realizimit të buxhetit, ndërsa te Drejtoria e Sportit 0% investime, asnjë fushë e ndërtuar sportive! Drejtoria e Arsimit, asnjë shkollë e ndërtuar, e asnjë çerdhe e re publike nga Komuna etj. Me këtë trend me kaq pak vullnet dhe dije nga kjo qeverisje, këtë vit me siguri do të kemi përmbi 40 milionë euro bartje.

Eman Rrahmani tha se këtë vit rreth 5 milionë euro do të largohen prej investimeve kapitale, për shkak se mbi 4 milionë euro janë të grandit qeveritar që nuk janë shpenzuar, kështu që vlera totale e cila është në mungesë të investimeve kapitale, që është dashur të investohet në Komunën e Prishtinës, është 43 milionë euro. Të humbin të gjitha këto mjete është e pakuptueshme në çdo aspekt, kur dihet se Komuna ka nevojë për shkolla, rrugë etj. Shpresoj që do të fillohet të punohet diçka, sepse kjo situatë nuk është normale, është shqetësuese.

Fadil Gashi kërkoi nga kryetari që t'i shkarkojë nga detyra drejtorët e pandërgjegjshëm, pasi që me këta drejtorë nuk mund të funksionojë Komuna, të cilët nuk mund të realizojnë as 50% të shpenzimeve.

Egzon Azemi tha se po t'i referohemi të dhënave rreth shpenzimeve që janë paraqitur në raport, kjo tregon më shumë, sa keq janë shpenzuar edhe ato mjete që janë shpenzuar, në një anë mungesë e shpenzimit të buxhetit, e në anën tjetër keq shfrytëzimi.

Mandej, në anën tjetër, Zyra ligjore e Komunës nuk përfaqëson asgjë, pra të mos merret asnjë veprim brenda dy vite e gjysmë, sinqerisht është e pakuptueshme.

Arbër Vokrri, lidhur me raportin, kryesisht u ndërlidh me pjesën e cila i takon shëndetësisë, i cili tha se në njërën anë po tepron buxheti, e në anën tjetër nuk po plotësohen vendet e punës që kanë mbetur të zbrazëta. Mandej vërehet se janë akorduar dhe janë shpenzuar mjetet për ndërtim të QMF-së në Veterernik, pra ne nuk po kemi punëtorë në këto qendrat ekzistuese, e po ndërtojmë edhe një qendër tjetër, ku është ideja! Pse duhet me qenë kjo shqetësuese, pse duhet me pyetur çfarë shërbimi shëndetësor marrin qytetarët, nëse vazhdimisht ballafaqohen me staf të lodhur të mbingarkuar. Shqetësuese janë edhe pagat e stafit të sigurimit, rojeve, vazhdimisht vonohen edhe ndodh që një prej pagave nuk ua jepen punëtorëve, e këtë shqetësim e kam parashtruar edhe më herët.

Drilon Pireva tha se Komuna e Prishtinës ka një progres të jashtëzakonshëm në realizimin e shpenzimeve të mjeteve, krahasuar me komunat e tjera fqinje. Për realizimin e projekteve kapitale ndikojnë shumë faktorë, siç janë shpronësimet e tokës, pra këto janë probleme, për shkak se Komuna e Prishtinës është vend i interesave të mëdha.

Shefki Gashi shprehu mendimin se Ligji për vetëqeverisjen lokale i ka dhënë shumë kompetencë Kryetarit të Komunës, sa që nuk ka kush e kontrollon. Pra duhet të ndizen dritat e kuqe, çka mundemi me bërë, sepse kompetencat i kemi aq të kufizuara sa që me të vërtetë është problem.

Ne kemi tepriçë të mjeteve financiare, por shikuar në realitet, i kemi më se 27 vendbanime pa pikë uji, kështu që kërkoj që në këtë drejtim të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi.

Naime Osmani tha se që 6 vjet çdo kërkesë që e kam bërë, sidomos për fshatrat, asnjë projekt nuk është realizuar, kur e dimë se Prishtina ka një buxhet dhe si është ndarë ai buxhet. Gjithashtu në listën buxhetore në kuadër të Drejtorisë së Administratës, nuk është cekur çmimi se sa janë blerë llaptopët që janë dhënë për anëtarët e Kuvendit. Këta llaptop kanë shumë probleme dhe na paraqesin shumë vështirësi gjatë përdorimit të tyre.

Nol Nushi theksoi se është mirë me qenë të sinqertë në kritikën ndaj këtij raporti, pra lehtë është me bërë akuza dhe kritika. Një prej shkaqeve që ka ndikuar në mos realizimin e projekteve është edhe Ligji i prokurimit. Duhet ditur se kur kryhet një projekt, teprojnë para, ato para praktikisht janë të pashpenzuara dhe të hyrat që vijnë pas pothuajse periudhës së shtatorit, 3 muaj ditë të hyra që vijnë janë të pashpenzuara në vitin kalendarik.

Për specifika, nuk besoj që ka komunë që e specifikon më shumë këtë raport.

Lidhur me vërejtjet, sugjerimet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociala, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës dhe Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Kryesuesi konstatoi se më 14 vota për, 17 kundër dhe 3 abstenime, nuk u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor, 2019.

Pika e tretë

Raporti buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar-31 dhjetor, 2019.

Kryesuesi konstatoi se më 14 vota për, 17 kundër dhe 3 abstenime, nuk u miratua Raporti buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor, 2019.

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 34 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020.

Pika e pestë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit.

Halim Halimi tha se është më se e nevojshme, që me rastin e këmbimit të tokave me na njoftuar ekzekutivi, se ne nuk e dimë, janë shumë të paqarta parcelat dhe numri i tyre që duhet me u këmbyer me pronën komunale.

Ai kërkoi që të bëhet një regjistër, të jetë një rend me emër e mbiemër të pronarëve për këmbime, pasi që kemi në pritje shumë pronarë, që katër vjet, dhe nuk vijnë në radhë.

Vjosa Hamiti-Kransiqi tha se në vendim të pronës së paluajtshme, pika e pestë e vendimit, në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit, shkruan zona kadastrale "Prishtina e Re", mendoj se mund të jetë gabim teknik, pasi që nuk ekziston kjo zonë kadastrale.

Leutrim Retkoceri tha se po t'i referohemi Ligjit të ri për këmbim, që është ndryshuar dhe ka hyrë në fuqi në vitin e kaluar, Komuna duhet të sigurojë vlerësimin e pronës së paluajtshme të Komunës, e cila është planifikuar për këmbim në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi, pra para se me kaluar ky propozim i kryetarit, duhet të ketë vlerësim të pronave me ligjin e ri, edhe ky vlerësim nuk është bërë. Andaj kërkoj që të mos votohen këto pika, për shkak se nuk është në harmoni me Ligjin e ri, nuk jemi te interesuar me bërë shkelje ligjore dhe për këto shkelje le të merr përgjegjësi Kryetari.

Jeta Rafuna-Hasani tha se të gjitha këto propozimvendime për këmbim të pronave, asnjë herë nuk kanë kaluar përmes Komitetin për Pronë. Përderisa nuk sillen këto në komitet, personalisht nuk do t'i votoj.

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 6 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Naxhije (Rashit) Herticës, Bahrije Pakashticës dhe Mustafa Pakashticës.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për, 4 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Naxhije (Rashit) Herticës, Bahrije Pakashticës dhe Mustafa Pakashticës.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Zuka (Isuf) Bekës.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për dhe 7 kundër, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Zuka (Isuf) Bekës.

Pika e tetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arton Topanicës, Ismit (Avdi) Shabanit, Sabit (Avdi) Shabanit, Adem (Shaban) Berishës dhe Sylejmon (Sadik) Topanicës.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për, 5 kundër dhe 2 abstenime, u miratua vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arton Topanicës, Ismit (Avdi) Shabanit, Sabit (Avdi) Shabanit, Adem (Shaban) Berishës dhe Sylejmon (Sadik) Topanicës.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 6 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 6 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për shitjen e automjeteve si pronë e luajtshme e Komunës.

Kryesuesi konstatoi se me 29 vota për dhe 1 abstenim, u miratua vendimi për shitjen e automjeteve si pronë e luajtshme e Komunës.

Pika e trembëdhjetë Pyetje dhe përgjigje

Kushtrim Sopa parashtroi këto pyetje dhe kërkesa:

Për Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës:

1. A ka mundësi buxhetore dhe ligjore Komuna e Prishtinës për rritjen e numrit të punëtorëve në digasterët e veçantë, të cilat kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe pastërtinë, me shkas që të pastrohet çdo cep i Prishtinës nga mbeturinat, në mënyrë që të duket më bukur kryeqyteti ynë (shembull konkret kemi qytetin e Tiranës)?

Për Gëzim Mehmetin, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

1. A do të sanohen gropat dhe kur, gropa të cilat janë të ekspozuara me theks të veçantë në lagjet: "Aktash", "Pejton", "Tophane", "Kalabria", "Kodra e Trimave", "Kolovica" etj.?
2. Pse nuk po trajtohet me urgjencë problemi i kolektorit në lagjen "Kalabria"? Për më shumë se 2 vjet, asnjë punëtor nuk është vërejtur atypari. Rruga është prishur kur kanë filluar punimet, ndërsa gjendja tash është tejet shqetësuese dhe alarmante. Kryetari dhe drejtorët përkatës komunalë, po arsyetohen se kanë probleme me shpronësim, mirëpo mijëra banorë, me theks të veçantë fëmijët rrezikohen nga gropat që janë hapur (me madhësi të jashtëzakonshme), si dhe rruga e dëmtuar, ku gjendja me të vërtetë aty është e tmerrshme;
3. Kur do të fillojë renovimi i Palestrës së madhe në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, si dhe kur do të fillojnë punimet për Palestrën e re të premtuar nga Kryetari i Komunës sonë?
4. Njëra prej premtimeve të kryetarit aktual ishte rruga unazë, prej Xhamisë së Llapit deri tek rrethi i shkallëve të lagjes "Arbëria", si shkas banorët nën hekurudhë janë tejet të shqetësuar me këtë rast, sepse ata kanë mbetur peng, ngase nuk ju lejohet ndërtim individual as kolektiv, madje as Komuna nuk po e zbaton njërën prej premtimeve të veta.
A do të ndërmerret diçka në këtë rast?
5. Kur do të rifillojnë punimet në platonë e oborrit (këndi i lojërave) në lagjen "Qafa", ngase prej muajsh të tërë kemi pasur vetëm një germim të lehtë dhe e tëra ajo plato është shndërruar në një pusetë të vogël me raste, edhe parking i bizneseve afariste aty pari, ndërsa destinimi i asaj pjese dihet?

Për znj. Medina Braha, drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

1. A ka Komuna e Prishtinës një plan dinamik, i cili parasheh krijimin e hapësirave të reja të parkimit, me zbatimin e masave sanksionuese?
2. Si mund të rregullohet timingu (orari) i linjave të autobusëve, duke e veçuar në këtë rast linjën e autobusëve me nr.7, të cilët sipas qytetarëve të Kolovicës, janë tepër të papërgjegjshëm, ngase ata qarkullojnë pa orar, një në 15-20-30 minuta, kurrë nuk ka orar të linjës të definuar?
3. A lejohet vendosja e reklamave të bizneseve afariste në këndet (telat) e miniparqeve tek Ora e Kurrizit në lagjen "Dardania", si dhe prerja e atyre telave për arsye të ulëta afariste?

Për znj. Shpresa Shalën, drejtore e Drejtorisë së Arsimit:

1. Siguria në shkolla dhe rreth shkollave është nën nivelin e dëshiruar, a do të merren masa edhe në këtë aspekt, bashkë me Policinë e Kosovë dhe Ministrinë e Arsimit?

Për Genc Bashotën, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm:

1. A do të merren masa për Çarshinë e Vjetër dhe objektet e vjetra, të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht me ruajtjen e trashëgimisë së qytetit tonë?

Mbledhja përfundoi 12:55.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta

